

## E DREJTA PËR INFORMIM



### Raporti Vjetor 2022 prezantohet në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, prezantoi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2022.

Për më shumë informacion rreth veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit gjatë vitit 2022, mund të konsultoni raportin duke klikuar në lidhjen:

<https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>

### PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 19 - Bashkia Kurbin

Vendim Nr. 21 - Spitali Psikiatrik "Sadik Dinci"



# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit maj 2023

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit maj 2023, ka dhënë 2 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

Me vendimin nr. 21, datë 19.05.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinci" Elbasan (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacione si vijon:

1. Kopje të kontratës së shërbimit të lavanderisë me kompaninë "DEVIS" sh.p.k.;
2. Raport vlerësimi të cilësisë për tenderin e lavanderisë me këtë kompani;
3. Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "Olta Sharra";
4. Kopje të vlerësimit të cilësisë apo performancës së kontratës së "Olta Sharra";
5. A disponon informacion spitali lidhur me kompanitë kontraktuese si në rastin e "DEVIS" sh.p.k., "Olta Sharra" për dyshimet për pronar me rekorde kriminale;
6. Tendera të tillë janë përcaktuar me flamur të kuq sa i përket procedurës së tenderimit. C'farë mendimi kenë për këtë fakt;

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Zyra e Komisionerit, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion.

Autoriteti Publik, ka bërë me dije se: "Kërkuari i informacionit është paraqitur pranë Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinci", Elbasan dhe gjatë takimit ka marrë përgjigje për çdo pyetje si dhe ka

shpjeguar ato pika të e-mailit të cilat ishin të pakuptueshme nga Autoriteti Publik. Spitali Psikiatrik "Sadik Dinci" Elbasan, në rastin e procedurës së prokurimit për shërbimin e cateringut nuk është Autoriteti Kontraktor që ka zhvilluar procedurën e prokurimit por bazuar në Vendimin nr. 82, datë 14.02.2018, i ndryshuar, "Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime" procedura është zhvilluar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara për këtë arsye kërkuari i informacionit ra dakord që do të kërkonte informacion pranë këtij Autoritetit Kontraktor. Referuar sa parashtruar më sipër u ra dakord që nga ana Institucionit tonë e kishte të qartë informacionin e kërkuar."

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar ankimin me pretendimin se: "...Nga biseda që unë kam realizuar me drejtorin e Spitalit Psikiatrik dhe juristen e tij është hequr pjesa e tenderimit pasi i perket një institucioni tjetër si procedurë por kanë mbetur të pa ezuruara pikat e tjera të kërkesës. Unë i kam kërkuar spitalit kopje të kontrateve për të cilat është ai institucioni përgjegjës. Për pikat më poshtë pres një përgjigje nga ana e spitalit psikiatrik "Sadik Dinci": 1) Kopje të kontratës së shërbimit të lavanderisë me kompaninë "DEVIS" sh.p.k. (përfshirë marreveshjen kuader); 2) Vlerësim performancë nëse ka; 3) Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë "Olta Sharra", (përfshirë marreveshjen kuader); 4) Kopje të vlerësimit të cilësisë apo performancës së kontratës së "Olta Sharra"..."

Pas nderhyrjes së Komisionerit, ankuesi ka vijuar ankimin me pretendimin se mungonte një kopje e kontratës së fundit të nënshkruar me kompaninë "Olta Sharra" si dhe me kompaninë "DEVIS" sh.p.k..."

Në këto kushte, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se "informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit "Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati,

"gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik". Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar.

Bazuar në shkronjën "a" të pikës 1, të nenit 2 të LDI parashikohet se: "Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënese, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj".

Në kuptim të këtij parashikimi, Spitali Psikiatrik "Sadik Dinci" Elbasan, është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: "1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike". Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, parashikohet se: "Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuari të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij".

Zyra e Komisionerit vendosi, pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

# Zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit dhe ai për mbrojtjen e të dhënave personale, takime në Gjirokastrë



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi në qytetin e Gjirokastrës një aktivitet me 3 komponentë: për ndërgjegjësimin e qytetarëve, takim me përfaqësues të institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë qark, si dhe shkëmbimin e praktikës së mirë në kuadër të transparencës me publikun. Gjatë ditës së parë, me fokus ndërgjegjësimin e qytetarëve, stafi i Zyrës së Komisionerit bashkëbisedoi për t'iu shpjeguar ushtrimin e të drejtave të tyre në fushën e aksesit në informacionin/dokumentacionin publik, në atë të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe shpërndau botime të ndryshme.

Ditën e dytë, në bashkëpunim me Prezencën në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), u zhvillua takim njohës e ndërgjegjësuës për zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë aktivitet morën pjesë, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, zyrtari i lartë ligjor i OSBE, z. Mauro Puzzo, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, z. Flamur Golemi dhe përfaqësues të autoriteteve të ndryshme publike të këtij qarku. Ky takim rajonal kishte si qëllim prezantimin e kuadrit rregullator për të dy fushat e përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit, ashtu si dhe veprimtarinë monitoruese e mbikëqyrëse për zbatimin e tyre. Gjithashtu, vëmëndje iu kushtua risive që do të sjellë legjislacioni i ardhshëm kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, që transponon tërësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), si dhe ndryshimeve e përmirësimeve të ligjit “Për të drejtën e informimit”.



Në përfundim të aktiviteteve në këtë qytet, Komisioneri Dervishi iu bashkua stafit të Bashkisë Gjirokastrë në takime me qytetarë, për të ndarë eksperiencën më të mirë në transparencën proaktive dhe trajtimin e kërkesave për informacion sipas standardeve ligjore.

# Shkëmbimi i praktikave të mira në funksion të transparencës së Autoriteteve Publike

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në Takimin e 2-të të Punës të Rasteve të Veçanta (Case Handling Workshop - CHW). Ky takim u organizua nga Autoriteti Federal për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga mbi 20 institucione homologe evropiane.




Në fokus të diskutimeve e shkëmbimit të eksperiencave në këtë takim ishin ngjashmëritë ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit rregullator, ashtu si edhe raste praktike. Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit prezantuan 2 çështje me ndjeshmëri të lartë në Shqipëri si “Transparenca proaktive efektive e Autoriteteve Publike” dhe “Informacioni publik në çështjet gjyqësore”. Pjesëmarrësit në takim patën pyetje të shumta rreth këtyre temave. I ftuar i nderit në aktivitet ishte dhe një përfaqësuesi i organizatës jo fitimprurëse në Gjermani “Open Knowledge Foundation”, i cili ndau me të pranishmit eksperiencën e platformave elektronike dhe fushatave të shoqërisë civile për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve ndaj të drejtës për informim publik.

Ushtrimi i të drejtës për informim nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile apo dhe medias ka ndikuar në rritjen dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike ndër vite. Nga ana tjetër, shkëmbimi i përvojave në takime të kësaj natyre nxit zgjerimin e njohurive dhe praktikave, në funksion të forcimit të kulturës së transparencës.


**Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:**



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMP)